



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 të Udhëzimit Administrativ (MAPL), Nr. 06/2018, për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, neni 44 , lidhur me nenin 49 të Ligjit nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 21 paragrafi 3 pika 3.1 të Ligjit për Paga e nëpunësve Civil Nr. 03/L147 i datës 13.05.2010, nenit 11 paragrafi 6, pika 6.1 të Rregullores Nr. 33/2012 për shtesat në paga dhe kompensimet e tjera për nëpunësit Civil dhe nenit 52 te Statutit komunës se Pejës 30.shtator 2020, Kryetari Komunës z. Gazmend Muhaxheri, më 10.08.2021, merr këtë:

V E N D I M
Për caktimin e Zyrtarit përgjegjës

- I. Z. Arianit Demaj**, udhëheqës i Zyrës për Informim Publik pran zyrës se Kryetarit te Komunës,
CAKTOHET:
- I.I. zyrtar përgjegjës për menaxhimin e platformës së konsultimeve publike dhe koordinimin e zbatimit të standardëve minimale te konsultimit publik në Komunën e Pejës.
- II.** Detyrat dhe përgjegjësit e zyrtarit përgjegjës për menaxhimin me platformën e konsultimeve publike dhe koordinimin e zbatimit të standardëve minimale te konsultimit publik në Komunën e Pejës, janë të përcaktuara me udhëzimin administrativ Nr. 06/2018 (MAPL) për standardet minimale te konsultimit publik ne Komuna.
- III.** Zyrtari përgjegjës i cekur në piken I dhe I.I te këtij vendimi ka te drejtë kompensimi për punën shtese dhe jashtë orarit te punës, me 30% te pagës bazë për ore te plote për punën jashtë orarit te rregullt dhe gjate ditëve te punës dhe ditëve te vikendit.
- IV.** Ky vendim hyn ne fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës se Kryetarit
- Drejtoratit për Buxhet dhe Financa,
- Zyrës se Personelit,
- Zyrtarit për paga dhe mëditje
- Zyrtarit z. Arianit Demaj
- Arkivit.

L.nr. 01/01/2021/83490/2021
Pejë, 10 Gusht 2021


Gazmend Muhaxheri
Kryetar i Komunës

